

Classic sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	3-4
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	5
PASQYRA E PERFORMANCËS	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	7
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	8
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	9-22

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe Ortakut të Vetëm të Shoqërisë Classic shpk

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të shoqërisë **Classic shpk** (më poshtë "Shoqëria") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2015, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues.

Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësitë e Audituesit të Pavarur

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, sikurse edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Bazat për Opinion me Rezervë

Sic përshkruhet në shënimin 5, 6 dhe 7 të pasqyrave financiare Kërkesat e arkëtueshme përbehen nga të arkëtueshme tregtare, të arkëtueshme nga palët e lidhura dhe të tjera llogari të arkëtueshme të cilat paraqiten respektivisht në vlerat 110,439,448 lekë, 210,023,473 dhe 1,185,770 lekë, të cilat janë të krijuara prej më shumë se një viti. Shoqëria nuk mund të vlerësojë mundësinë e arkëtimit të një pjesë të këtyre kërkesave. Në mbyllje të vitit ushtrimor Shoqëria nuk ka njohur ndonjë shumë për parashikimin e zhvlerësimit të kërkesave për arkëtim. Mbi bazë të informacioneve që kemi marrë, ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektin që ndonjë korrëgjim i mundshëm nga zhvlerësimi i mëtejshëm i llogarive të arkëtueshme do të kishte në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Shuma e zhvlerësimit deri në masën e vlerës së tyre të rikuperueshme do ulte vlerën e aktiveve dhe të kapitaleve të veta në të njëjtën masë.

Sic përshkruhet në shënimin 8 të pasqyrat financiare të shoqërisë, gjendja e inventarëve të Shoqërise me 31 Dhjetor 2015 është 69,171,570 Lekë. Inventarët më 31 Dhjetor 2015 përfshijnë njësi inventari të cilat nuk kanë qarkulluar për më shumë se një vit, dhe për të cilat manaxhimi i shoqërisë nuk ka analizuar nëse vlera e tyre e rikuperueshme do të jetë më e vogël se kosto e blerjes. Për sa më sipër në nuk arritëm të përfitonim një siguri të arsyeshme në lidhje me vlerësimin e gjendjeve të inventarit. Shuma e zhvlerësimit deri në masën e vlerës së tyre të rikuperueshme do të ulte vlerën e inventarëve dhe të kapitaleve të veta në të njëjtën masë.

Sic përshkruhet në shënimin 12 dhe 13 të pasqyrave financiare Llogaritë e pagueshme përbehen nga llogari të pagueshme tregtare dhe llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura, të cilat më 31 Dhjetor 2015 paraqiten respektivisht në vlerat 75,213,586 lekë dhe 80,518,708 lekë. Deri në datën e Raportit të Auditimit ne nuk kemi përfunduar një pjesë të rëndësishme të procedurave të auditimit në lidhje me marrjen e konfirmimeve direkte nga palët e treta. Pas përfundimit të procedurave alternative ne nuk arritëm të përfitonim një siguri të arsyeshme në lidhje me saktësinë e shumave të përfshira në keto zëra të pasqyrave financiare.

Opinion me Rezervë

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të mundshme të çështjeve të përshkruara në paragrafin "Bazat për Opinion me Rezervë", pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të **Classic shpk** më datën 31 dhjetor 2015, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

I.L.D-99 Audit sh.p.k

31 Maj 2016



Luan Kamberi

Classic shpk*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015**

	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	14,647,428	2,883,007
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	110,439,448	297,170,500
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	210,023,473	232,813,323
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	1,185,770	1,506,571
Inventari	8	69,171,570	90,065,194
Shpenzime të shtyra	9	1,775,625	20,467,586
Total aktive afatshkurtra		407,243,314	644,906,181
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	10	491,121,014	540,515,637
Total aktive afatgjatë		491,121,014	540,515,637
Total aktive		898,364,328	1,185,421,818
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	11	596,774,151	649,447,650
Llogari të pagueshme tregtare	12	75,213,586	170,328,226
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	13	80,518,708	82,193,473
Detyrime tatimore	14	2,583,007	12,168,430
Total detyrime afatshkurtra		755,089,452	914,137,779
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	15	102,371,748	219,915,458
Të ardhurat e shtyra	16	15,218,435	13,938,816
Të tjera detyrime	17	13,897,350	25,685,939
Total detyrime afatgjatë		131,487,533	259,540,213
Totali i detyrimeve		886,576,986	1,173,677,992
KAPITALI			
Kapitali i nenshkruar		88,000,000	88,000,000
Rezerva statutore		166,500	166,500
Rezerva ligjore		13,500	13,500
Fitime të mbartura		(76,436,174)	(62,761,684)
Fitimi i ushtrimit		43,516	(13,674,490)
Total kapitali	18	11,787,342	11,743,826
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		898,364,328	1,185,421,818

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 9 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Classic shpk*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Performancës****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	19	753,471,792	629,200,936
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	20	10,027,930	11,625,239
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(662,076,119)	(523,854,667)
Lënda e parë dhe materiale të			
1) konsumueshme	21	(642,869,791)	(495,579,042)
2) Të tjera shpenzime	22	(19,206,328)	(28,275,625)
Shpenzime të personelit	23	(32,678,130)	(34,867,912)
1) Paga dhe shpërblime		(28,148,050)	(30,039,300)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shëndetësore		(4,530,080)	(4,828,612)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(34,555,263)	(47,577,102)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit		(993,713)	(3,019,582)
Shpenzime financiare		(33,045,046)	(45,181,402)
Shpenzime interesi dhe shpenzime të			
1) ngjashme	24	(43,902,729)	(44,302,059)
2) Shpenzime të tjera financiare	25	10,857,683	(879,343)
Fitimi/humbja para tatimit		151,451	(13,674,490)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	26	(107,935)	-
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(107,935)	
2) Shpenzimi aktual i tatimit te shtyre		-	
Fitimi/humbja e vitit		43,516	(13,674,490)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse		43,516	(13,674,490)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 9 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Classic shpk*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Fitimet e Pashpërdara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni më 1 janar 2014	88,000,000	13,500	166,500	(4,479,723)	(58,281,961)	25,418,316
Totali i të ardhura gjithpërfshirëse për vitin: Transferim ne fitim/humbje te mbartura				(58,281,961)	(13,674,490) 58,281,961	(13,674,490) -
Pozicioni më 31 dhjetor 2014	88,000,000	13,500	166,500	(62,761,684)	(13,674,490)	11,743,826
Të ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin: Transferim ne fitim/humbje te mbartura				(13,674,490)	43,516 13,674,490	- 43,516
Pozicioni më 31 dhjetor 2015	88,000,000	13,500	166,500	(76,436,174)	43,516	11,787,342

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 9 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori i Classic shpk më _____ dhe janë firmosur si më poshtë:

Z. Artan Qesko
Administrator

Znj. Mimoza Palushi
Drejtuese e Financës

Classic shpk
(Vlerat janë në Lek)
**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	43,516	(13,674,490)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	(8,396,106)	91,297
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	34,555,263	47,577,102
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	(6,182,189)	(6,615,603)
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	228,533,664	(109,856,196)
Rënie/(rritje) në inventarë	20,893,624	32,490,985
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(105,095,209)	76,315,108
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	-	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	164,352,563	26,328,203
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(19,633,668)	(56,308,016)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	40,655,217	33,573,743
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	21,021,549	(22,734,273)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara		52,445,503
Pagesa e huave	(182,005,797)	(66,272,415)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(182,005,797)	(13,826,912)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	3,368,315	(10,232,982)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	2,883,007	13,207,286
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	8,396,106	(91,297)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	14,647,428	2,883,007

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 9 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Classic" shpk është krijuar në korrik 1999, me vendim gjykate Nr. 21604. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse në përputhje me ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Shoqëria ka nipt NIPT J91909004J.

Shoqëria është një shoqëri shqiptare me ortakë:

- Z. Agron Papuli, zotëron 66.67% të kuotave të kapitalit të shoqërisë

- Z. Artan Qesko, zotëron 33.33% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë është 88,000,000 Lek, i ndarë në 100 pjesë me vlerë 880,000 Lek secila. Administrator i shoqërisë është Z. Artan Qesko.

Selia e shoqërisë është në Autostradën Tiranë-Durrës, km 1, rruga dytësore, Godina Nr. 8, Kashar, Tiranë.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie, si përfaqësues ekskluziv i firmës "Volkswagen A.G" është tregtimi dhe riparimi i automjeteve të grupit Volkswagen, Organizimin e panairove dhe ekspozitave për paraqitjen e automjeteve, dhënia e automjeteve me qira, etj.

Në 31 dhjetor 2015 shoqëria ka 38 punonjës. (2014: 46).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrin nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2015	2014
Euro/Lek	137.28	140.14
Usd/ Lek	125.79	115.23

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendje të mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlerë e mbetur	5%
Makineri e Pajisje	Vlerë e mbetur	20%
Mjete Transporti	Vlerë e mbetur	20%
Pajisje Zyre	Vlerë e mbetur	20%
Pajisje Kompjuterike	Vlerë e mbetur	25%
Të tjera	Vlerë e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto (pa TVSH dhe zbritjet tregtare) të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike raportuese, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitaleve të veta.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.13. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Depozita në bankë e llogari të tjera	14,517,247	2,825,311
Vlera në arkë	130,181	57,696
	<u>14,647,428</u>	<u>2,883,007</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Klientë për shitje makinash	27,634,770	203,667,550
Klientë për shitje pjesësh	33,483,676	39,680,281
Klientë Leasing Qira	48,519,567	53,121,829
Të tjera	801,435	700,840
	<u>110,439,448</u>	<u>297,170,500</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve	154,034,606	167,534,295
Hua të dhëna palëve të lidhura	55,988,867	65,279,028
	<u>210,023,473</u>	<u>232,813,323</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Tatim fitimi i mbipaguar	330,115	438,050
Paradhënie punonjësish	-	203,400
Të tjera të arkëtueshme	855,655	865,121
	<u>1,185,770</u>	<u>1,506,571</u>

8. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqitet si me poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Makina	10,448,842	27,228,863
Pjesë këmbimi	58,722,728	62,836,331
	<u>69,171,570</u>	<u>90,065,194</u>

9. Parapagime dhe shpenzime të periudhave të ardhshme

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Parapagime dhe shpenzime te shtyra	1,775,625	20,467,586
	<u>1,775,625</u>	<u>20,467,586</u>

10. Aktive Afatgjata Materiale

	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Mobilje dhe pajisje zyre	Pajisje informatike	Të tjera	Totali
Kosto							
Gjendja më 1 janar 2014	340,000,000	50,645,666	366,083,702	20,385,680	10,106,896	9,918,233	797,140,177
Shtesa	30,000,000	438,668	25,056,451	16,800	45,475	750,622	56,308,016
Nxjerrje jashtë përdorimit			(54,411,189)	(1,095,750)			(55,506,939)
Gjendja më 31 dhjetor 2014	370,000,000	51,084,334	336,728,964	19,306,730	10,152,371	10,668,855	797,941,254
Shtesa	15,000,000	71,666	4,293,800	-	46,163	222,039	19,633,668
Nxjerrje jashtë përdorimit			(84,213,387)	(3,192,163)		(2,411,943)	(89,817,493)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	385,000,000	51,156,000	256,809,377	16,114,567	10,198,534	8,478,951	727,757,429
Amortizim i akumuluar							
Gjendja më 1 janar 2014	20,486,250	39,060,102	149,918,694	15,108,495	7,831,333	5,992,440	238,397,314
Amortizimi i vitit	-	2,084,661	43,569,090	884,267	533,300	505,784	47,577,102
Rimarrje e amortizimit per AAM e shitura			(27,972,253)	(576,546)			(28,548,799)
Gjendja më 31 dhjetor 2014	20,486,250	41,144,763	165,515,531	15,416,216	8,364,633	6,498,224	257,425,617
Amortizimi i vitit	-	1,701,738	31,309,029	656,589	407,130	480,777	34,555,263
Rimarrje e amortizimit per AAM e shitura			(50,682,951)	(2,818,887)		(1,842,627)	(55,344,465)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	20,486,250	42,846,501	146,141,609	13,253,918	8,771,763	5,136,374	236,636,415
Vlera neto kontabël							
Gjendja më 31 dhjetor 2014	349,513,750	9,939,571	171,213,433	3,890,514	1,787,738	4,170,631	540,515,637
Gjendja më 31 dhjetor 2015	364,513,750	8,309,499	110,667,768	2,860,649	1,426,771	3,342,577	491,121,014

11. Hua afatshkurtër

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Huamarrje Afatshkurtra nga bankat	555,545,940	523,432,023
Pjesë afatshkurtër e huasë afatgjatë	41,228,212	124,701,932
Interesa Kredie		1,313,695
	<u>596,774,151</u>	<u>649,447,650</u>

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Furnitorë për blerje mallrash dhe shërbimesh	75,213,586	170,328,226
	<u>75,213,586</u>	<u>170,328,226</u>

13. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	80,518,708	82,193,473
	<u>80,518,708</u>	<u>82,193,473</u>

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Sigurime shoqërore e shëndetësore	754,089	675,063
Tatim mbi të ardhurat personale	-	159,750
TVSH	1,828,918	11,333,617
	<u>2,583,007</u>	<u>12,168,430</u>

15. Hua afatgjata

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Huamarrje nga bankat	102,371,748	219,915,458
	<u>102,371,748</u>	<u>219,915,458</u>

16. Të ardhura të shtyra

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Të ardhura të periudhave të ardhshme	15,218,435	13,938,816
	<u>15,218,435</u>	<u>13,938,816</u>

17. Të tjera detyrime

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Të tjera hua afatgjata të dhëna të tretëve	13,897,350	25,685,939
	13,897,350	25,685,939

18. Kapitali

	31 dhjetor 2015		31 dhjetor 2014	
	Vlera	Nr i kuotave	Vlera	Nr i kuotave
Z. Agron Papuli	58,669,600	66.67	58,669,600	66.67
Z. Artan Qesko	29,330,400	33.33	29,330,400	33.33
Totali	88,000,000	100.00	88,000,000	100.00

Shoqëria ka realizuar fitim gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2015 në vlerën 43,516 Lek (2014: (13,674,490) Lek).

19. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Nga shitja e makinave	575,806,581	430,481,918
Nga shitja e pjesëve të këmbimit	75,094,899	79,800,623
Nga makinat me qira e Leasing	76,848,240	95,170,144
Nga riparime dhe shërbime	25,722,072	23,748,251
	753,471,792	629,200,936

Rakordimi i të ardhurave me FDP-në:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Qarkullim i tatueshëm	799,675,174
Fature shtese nëntor 2015	(422,805)
Zbritten Autofaturimet 2015	
Shtohen të ardhurat e rimarra nga 2014	13,938,816
Zbritten të ardhura të shtyra për 2015	(15,218,435)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	797,972,750
Shifra e Afarizmit	753,471,792
Të ardhurat nga Shitja e AAM të paraqitura Neto tek të ardhura të tjera	40,655,217
Të ardhura të Tjera	3,845,741
Sipas Kontabilitetit:	797,972,750
Diferenca	-

20. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Rezultati nga shitja e AAM-ve*	6,182,189	6,615,603
Të ardhura të tjera	3,845,741	5,009,636
	10,027,930	11,625,239
<i>Rezultati nga shitja e AAM-ve:</i>		
Nga shitja e AAM-ve	40,655,217	33,573,743
Kosto e AAM-ve të shitura	(34,473,028)	(26,958,140)
	6,182,189	6,615,603

21. Lënda e pare, shërbime dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit, të cilat detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Mallra makina	497,725,851	356,228,220
Mallra dhe pjesë këmbimi	81,562,385	72,660,493
Qira ambjenti dhe makina	39,119,745	38,135,955
Materiale dhe riparimet të ndryshme	13,025,269	15,792,455
Karburant për makina e shitura dhe gjenerator	1,234,435	563,699
Siguracione dhe shpenzime për targat e makinave	5,858,338	6,093,825
Shpenzime të shërbimeve doganore	225,823	-
Shpenzime transporti	2,589,331	1,653,330
Riparime, pjesë makina garanci dhe brenda çmimit	1,240,786	4,377,652
Tarifa doganore	287,828	73,413
	642,869,791	495,579,042

22. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Taksa vendore	1,095,376	1,940,234
Shpenzime të ndryshme të pazbritshme	965,517	346,506
Konsulencë juridike e ekonomike	1,493,006	-
konsulenca të tjera	-	1,885,006
Kancelari e noterizime	1,064,465	1,425,237
Energji elektrike e ujë	2,302,341	3,017,721
Roje civile	1,520,000	1,920,000
Shpenzime telefoni e postare	2,966,392	3,822,826
Udhëtime e dieta	453,520	889,420
Të tjera	6,665,513	12,174,555
Shërbime bankare	442,677	498,018
Materiale pastrimi	237,521	356,102
	19,206,328	28,275,625

23. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Shpenzime page	28,148,050	30,039,300
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shendetësore	4,530,080	4,828,612
	<u>32,678,130</u>	<u>34,867,912</u>

24. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Gjoba dhe penalitete	993,713	3,019,582
	<u>993,713</u>	<u>3,019,582</u>

25. Shpenzime interesi

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Të ardhura nga interesat	408,649	1,007,414
Shpenzime interesi	(42,510,704)	(43,628,585)
Komisione	(1,800,674)	(1,680,888)
	<u>(43,902,729)</u>	<u>(44,302,059)</u>

26. Shpenzime të tjera financiare

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Të ardhura nga diferencat e kurseve të këmbimit	18,658,059	1,726,110
Shpenzime nga diferencat e kurseve të këmbimit	(7,800,376)	(2,605,453)
	<u>10,857,683</u>	<u>(879,343)</u>

27. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
<i>Fitimi para tatimit</i>	151,451	(13,674,490)
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	11,677,995	50,919,665
Shpenzime pritje & percjellje		
Shpenzime udhëtimi	453,520	
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	993,713	3,019,582
Shpenzime pa dokumenta të rregullta tatimor	-	11,306,831
Shpenzime të tjera	5,260,257	
Interesa të panjohura	4,970,505	36,593,252
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	11,829,446	37,245,175
Humbje fiskale e mbartur	(11,109,877)	(51,939,428)
Ulje e humbjes së mbartur sipas akt kontrollit	-	3,584,376
Fitimi i tatueshëm	719,569	(11,109,877)
Tatim fitimi @15%	107,935	-
	43,516	(13,674,490)

28. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.